

Shoqata kulturore «Shën Kosmai» me seli në Livadhja të Bashkisë Finiq është një shoqatë jofitimprurëse e pavarur. U themelua në vitin 2017. Ushtron veprimtarinë e saj kryesisht në zonën e Bashkisë së Finiqit dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë e jashtë saj. Synimi i Shoqatës është të iniciojë dhe mbështetë veprimtari kulturore - edukative në fushën e arsimit dhe gjuhës, në ruajtjen e vlerave ekologjike, natyrore, arkitekturore e turistike, përmirësimin e infrastrukturës në fushën e arsimit, organizimin e aktiviteteve kulturore, festivale, konferenca për të promovuar kulturën e zonës dhe për të dhënë kontributin e saj në zhvillimin e vlerave të traditës, trashëgimisë, kulturës dhe historisë së zonës sonë.